

## V E N D I M

### “Per caktim sekuestro preventive”

Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE : MIMOZA KAJO- BRAHIMI

Asistuar prej sekretares Suzana Murataj, në Tiranë me 26.11.2014 mori në shqyrtim materialin procedues që i përket :

K Ë R K U E S : Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë përfaqëson nga prokurori Endrit Bimi.

K U N D Ë R : Të dyshuarit (.....) ,i datëlindjes (.....), lindur dhe banues në Tiranë, rruga “(.....)”, Pallati Nr.(....), nr.(....) ne mungese.

A K U Z U A R P Ë R : Veprën penale të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.

O B J E K T I : Caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro Preventive”, per sendin/pasuri nr (.....), zonë kadastrale (.....), sipërfaqe toke truall 895 m2, nga kjo 147 m2 ndërtesa me kufizim pasurie (.....),(.....) duke urdheruar ZRPP Tirane te mos beje asnje veprim juridik ne lidhje me kete pasuri

B A Z A L I G J O R E : Nenet 274 i K.Pr.Penale.

Gjykata pasi shqyrtoi kerkesen e prokurorit qe kerkoi, caktim mase sigurimi pasuror sekuestro preventive për pasurine ne 2/128 të regjistruar në ZVRPP Tiranë, mbasi shqyrtoi aktet e bisedoi çeshtjen,

## V E R E N

Prokuroria e Rrethit Gjyqsor Tiranë, mbi bazën e materialit kallzues të dërguar Seksioni Për Krimin Ekonomik e Financiar, ka regjistruar këtë procedim penal, ne ngarkim te (.....), i dyshuar per kryerjen e vepres penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i K.Penal.

Ky procedim është regjistruar pasi më 23.11.2014 rreth orës 20.00 në Drejtorinë e Policisë Qarkut Tiranë, Seksioni Për Krimin Ekonomik e Financiar, është paraqitur shtetësja (.....), e vitlindjes 01.02.1928, lindur në Korçë dhe banuese në Tiranë, rruga “(.....)”, shtëpi private nr.(.....) Tiranë, e cila ka bërë kallzim ndaj shtetasit (.....) për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave”, veprë penale e parashikuar nga neni 186 i K.Penal.

Konkretisht, kallzuesja tregon si më poshtë:

*“Unë jetoj në njësinë bashkiake nr.1, rruga “(.....)”, shtëpi private nr.(.....), dhe në pronësinë time kam një shtëpi banimi me numër pasurie (.....), zonë kadastrale (.....), sipërfaqe toke truall 895 m2, nga kjo 147 m2 ndërtesa me kufizim pasurie (.....) (.....),(.....) .(.....) (.....). Kjo pronë është trashëguar nga babai im, i cili nuk jeton më, (.....)babai im (.....)ka pasë dy fëmijë, mua dhe motrën time e cila nuk jeton më (.....)unë nuk jam martuar asnjëher dhe nuk kam fëmijë brenda apo jashtë martese. Kurse motra ime (.....) ka qënë e martuar me shtetasin (.....) dhe nuk kanë patur fëmijë.*

*Në fillim të muajit nëntor të vitit 2014, kam aplikuar në ZRPP, Tiranë për rifreskimin e certifikatës së pronësisë së objektit dhe truallit që ju thashë më sipër. Me dt.05.11.2014 ZRPP Tiranë, më kthen përgjigje me postë duke vënë në dispozicion Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme për numrin e pasurisë time (.....), ku rezulton se prona ime është e regjistruar në emër të shoqërisë “Ana” sh.p.k, dhe jo vetëm aq por prona ime ishte lënë si garanci hipotekore në bankën Credins, për llogari të shoqërisë “Ana” sh.p.k për një vlerë prej (.....) euro.*

*Me dt.10.11.2014, kam aplikuar pranë ZRPP Tiranë për të marrë praktikën e kalimit të pronësisë nga unë tek shoqëria “Ana” sh.p.k, pasi unë jo vetëm që nuk kisha bërë asnjëher shitje të pronës time, por edhe nuk kisha dijeni për vjedhjen e pronës time.*

*Me dt.18.11.2014 kam marrë përgjigjen e ZRPP Tiranë e cila më ka vënë në dispozicion Kontratë Shitje Pasurie të Paluajtshme e dt.26.08.2013, para noterit Helian Zenelaj, me Nr.2199 Rep. dhe Nr.637/1 Kol., ku sipas kësaj kontrate unë i kam shitur pronën shtetasit (.....), i datëlindjes (.....), kontratë të cilën nuk e kam nënshkruar asnjëher dhe për të kam ardhë në dijeni këtë ditë që mora përgjigjen nga ZRPP Tiranë.*

*Po në këtë përgjigje ZRPP Tiranë më ka vënë në dispozicion Kontratë Sipërmarrje mes shoqërisë “Ana” sh.p.k dhe shtetasit (.....) e dt.27.09.2013 me Nr.2685 Rep, Nr.636/1 Kol. para noterit Shpresa Kurti si dhe kontratën e Shitjes së Pasurisë së*

*Paluajtshme mes shtetasit (.....) dhe shoqërisë “Ana” sh.p.k e dt.05.03.2014, me Nr.2359 Rep, Nr.763 Kol. para noterit Julian Zhelegu”.*

Në këto kushte rezulton se shtetasi (.....) ka regjistruar në pronësi të tij pronën e kallzueses, me anë të falsifikimit të dokumenteve, duke i shkaktuar kallzueses një dëm tepër të rëndë.

**Si e tille disponimi i prones objekt kallzimi ka ardhur si rezultat i vepres penale te falsifikimit te dokumenteve te kryera nga (.....).**

Gjykata cmon se pamvarësisht se prokurori nuk i ka atribuar, veprimet e të dyshuarit kanë elemente edhe te vepres penale të vjedhjes.

**Gjykata cmon se referuar nenit 36/1 germa ‘b’ te K.Penal dhe nenit 274/2 te K.Pr.Penale , trualli duhet te konsiderohet si nje send qe eshte objekt i sekuestros preventive .**

**Gjithashtu disponimi i lire i kesaj siperfaqeje nga ana e personave qe nuk jane pronaret e saj ka lidhje te drejtperdrejte me vepren penale ne ngarkim te personit nen hetim, pasi ky disponim ka ardhur nga veprimet ne kundërshtim me ligjin.**

**Si i tillë edhe ky disponim mund te rëdoje ose te zgjase pasojat e vepres penale.**

**Keshtu pronaret e vertete te kesaj siperfaqe nuk mund te disponojne ne te ardhmen ate si rezultat i tjetërsimit te truallit.**

Si konkluzion, caktimi nga Gjykata e mases se sigurimit pasuror ”Sekuestro Preventive” parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, cmohet si mase sigurimi e pershtatshme ne raport me rëndesine e faktit dhe pasojat që mund të vijnë nga vepre penale.

PER KETO ARESYE

Gjykata, ne mbështetje te neneve 244, 274 te K.Pr.Penale

V E N D O S I

-Caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro Preventive”, per sendin: **pasuri (.....) zonë kadastrale (.....), sipërfaqe toke truall 895 m2, nga kjo 147 m2 ndërtesa me kufizim pasurie (.....) duke urdheruar ZRPP Tirane te mos beje asnje veprim juridik ne lidhje me kete pasuri .**

-Ngarkohet policia gjyqësore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

-Kundër vendimit lejohet ankim nga personat e interesuar brenda 10 ditëve nga marrja dijeni në Gjykatën e Apelit Tiranë.

-U shpall sot me datë 26.11.2014.

S E K R E T A R E

SUZANA MURATAJ

G J Y Q T A R E

MIMOZA KAJO-BRAHIMI